



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec
RAHOVEC /ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 01(Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 01/129 Nr. i faq/Br.str/No.pg 86

Data/Datum/Date 24/03/2026

Në mbështetje të nenit 12 pika 1 dhe pika 2 shkronja d), nenit 14 pika 1, nenit 17 shkronja (c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 24 i Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10/2019”), nenit 29 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 paragrafi 2 pika 2.11, nenit 57 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017 dhe kërkesës për rishqyrtim të MAPL-së me Nr. Prot. 020-175/8 të datës 23.03.2026, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 24.3.2026 miraton këtë:

V E N D I M

Shpalljen me interesi të përgjithshëm publik të pjesës së parcelës P-71510057-02240-80 në Zonën Kadastrale Rahovec

1. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës me Nr. Prot. 02/6977/26 i datës 04.02.2026 dhe shpallet interesi i përgjithshëm publik pjesë e parcelës kadastrale sipas certifikatës së pronësisë P-71510057-02240-80 në Zonën Kadastrale Rahovec, në sipërfaqe prej 148m² (njëqind e dyzet e tetë metra katror) e cila ndahet nga sipërfaqja e përgjithshme prej 7512401m² (shtatë milion e pesëqind e dymbëdhjetë mijë e katërqind e një metra katror) në vendin e quajtur shumëkabilja glava, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të P.SH.E KOSOVES K.K.RAHOVEC SHF.EKO.E PYJ.RAHOVEC.
2. Qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm publik të parcelës së cekur në pikën 1 të këtij vendimi do të jetë “Hapja e rrugës për qasje në rrugë publike”.
3. Autorizohet Kryetari i Komunës që komform dispozitave ligjore në fuqi të ndërmer të gjitha veprime të nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
4. Bartës për rregullimin e dokumentacionit teknik dhe regjistrimin e pronës në Librin Kadastral do të jetë Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
6. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi 01 Nr. 106/26 i datës 25.2.2026.
7. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Kryetarit të Komunës,*
- *Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

KUVENDI I KOMUNËSNË RAHOVEC

01Nr.129/26
Datë:24.03.2026

